

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Farmacia e QSUT-së s'ka sistem, pacientët e Onkologjikut presin me orë të tëra ilaçet
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392433.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 08:51:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	18 shtator 2026, 08:47:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 18 shtator 2026, 08:46:00 UTC → 18 shtator 2026, 08:48:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3f4c7a9c8d27ca4283f4ead11d9e6e2507fcc8e81f75c99712d7a38f8c28c3e2
TEKSTI	ddaa6984b61398f475405cc17806c7f0b4c72a7419344a3a6d001de5e1f2a239
PAMJA	9a376fc156388dfd2413e538fe74b61f3e976e4fe21b8f8601f16beabb9e569a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	820dab8e6fa1d568f59f8ba0aa9014ede455e3f99a762629125cc4473174a317
E MËPARSHMJA	eb98dd6e5f4de908ab748873e75774dd31c960e6a855c737acb2d0abb14b3535
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/820dab8e6fa1d568f59f8ba0aa9014ede455e3f99a762629125cc4473174a317>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Farmacia e QSUT-së s'ka sistem, pacientët e Onkologjikut presin me orë të tëra ilaçet

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 18.09.2026, 10:47



Share



Share



Një problematikë e përsëritur në farmacinë pranë QSUT-së po shkakton radhë të gjata dhe pritje disa orëshe për pacientët që paraqiten për të marrë injeksione, medikamente dhe barna të rimbursuara.

Në redaksinë tonë kanë mbërritur disa denoncime nga qytetarë, të cilët thonë se shkak i situatës është mungesa e funksionimit të sistemeve kompjuterike.

Sipas tyre, problemi nuk është i izoluar, por përsëritet në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht ditën e hënë dhe të premte.

Një qytetar shprehet se problematika është raportuar disa herë pranë zyrave të AKSHI-t, por, sipas tij, reagimi dhe zgjidhja vonojnë. Në një nga denoncimet, qytetari thotë se defekti ishte raportuar që në orën 08:00 të mëngjesit, ndërsa deri rreth orës 10:30 nuk kishte marrë ende një përgjigje apo ndërhyrje.

"E kemi adresuar shumë herë si problematikë, sepse është diçka që përsëritet."

Por shqetësimi bëhet edhe më serioz kur në radhë janë pacientë që ndodhen nën trajtim mjekësor, përfshirë pacientë onkologjikë.

Në një tjetër qytetare thotë se ditën e sotme pacientët kanë pritur rreth tre orë për të marrë barnat e tyre, përfshirë medikamente të rimbursuara. Sipas qytetarit, mungesa e sistemit po pengon marrjen në kohë të terapisë dhe po detyron pacientët dhe familjarët e tyre të qëndrojnë për orë të tëra në pritje.

"'Prania besnike' po i lë të sëmurët e onkologjikut pa ilaçe, nuk ka sistem, thonë", thuhet në denoncim.

Pacientët që paraqiten për barna apo terapi nuk mund të mbeten peng i një sistemi informatik që nuk funksionon, ndërsa institucionet përgjegjëse duhet të garantojnë një zgjidhje të qëndrueshme dhe një mënyrë alternative shërbimi në rast defektesh.

Në këtë situatë kaotike pyetjet që ngrihen janë të qarta: Pse një problem i raportuar disa herë vazhdon të përsëritet? Sa kohë duhet për rikthimin e sistemit në funksion? Dhe çfarë procedure ndiqet për pacientët që nuk mund të presin me orë të tëra për shkak të një defekti teknik?

Ministria e Shëndetësisë duhet të japë një shpjegim mbi situatën dhe mbi masat që do të merren për të shmangur përsëritjen e saj.

Denoncimi 1:

Pershendetje! Ju lutemi te adresoni nje problematike qe eshte sistematike ne lidhje me mungesen e sistemeve ne farmacine prane QSUT-se te farmacia ku pacientet marrim injeksionet apo medikamentet e ndryshme! Thone e kemi adresuar shume here si problematike sepse eshte diçka qe përsëritet dhe qe



Më të Lexuarat




Albania për
Media
Ethics

ARTIKULL JOETIK?

akorduar shpesh merrë orë për probleme dhe siç duket sikur dikush që personat e tyre që zyrat AKSH-it nuk japin asnjë përgjigje edhe pse është njoftuar që në orën 8:00 të mëngjesit, ora aktualisht është 10:30 dhe nuk ka ende asnjë përgjigje! Cdo të hënë dhe të premte është i njëjti problem që njëzëit presin në radhë për orë të tëra për shkak të mungesës së sistemeve!

Denoncimi 2:

"Prania besnike"po i lë të sëmurët e onkologjikut pa ilaçe, nuk ka sistem thonë!!Sot, pacientë të shumtë po presin me orë të tëra për të marrë barnat e tyre në farmaci, përfshirë barnat e rimbursuara. Pritja ka zgjatur rreth tre orë, ndërkohë që pacientët janë në pritje për të marrë terapinë e tyre. Problemi nuk është thjesht koha e pritjes. Bëhet fjalë për pacientë onkologjikë, shumë prej të cilëve janë në trajtim dhe kanë nevojë që terapia të nisë ose të vazhdojë në kohën e përcaktuar nga mjeku. Është e papranueshme që pacientët dhe familjarët e tyre të qëndrojnë për orë të tëra në pritje për shkak të mungesës së një sistemi funksional dhe të organizuar për marrjen e barnave. Kërkojmë nga media që të verifikojë këtë situatë në terren dhe nga institucionet përgjegjëse që të japin një shpjegim publik





FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!


Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.